



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DURRËS
KËSHILLI BASHKIAK

KOMISIONI I MARDHËNIEVE ME JASHTË DHE INTEGRIMIT
EVROPIAN

Datë 11.06.2026

RAPORT VENDIMMARRJEJE

Projekt-vendimin (*titulli i projektvendimit*): **PËR MIRATIMIN E PËRDORIMIT TË FONDIT PREJ 4010444 (KATËR MILIONË E DHJETË MIJË E KATËRQIND E DYZET E KATËR) LEKË TË PARAFINANCUARA NGA PROJEKTI SUSTAINABLE MOBILITY UPGRADE - SUMO 2.0, PROGRAMI INTERREG IPA SOUTH ADRIATIC (2021-2027) .**

Baza ligjore:

Në mbështetje të Ligjit nr. 65/2022 “Për ratifikimin e marrëveshjes financiare kuadër të partneritetit ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, dhe Komisionit Europian për rregullat specifike të zbatimit të asistencës financiare të BE-së për Republikën e Shqipërisë në kuadër të Instrumentit për Asistencën e Paraanëtarësimit (IPA III)”, Ligjit nr. 8/2024, “Për ratifikimin e marrëveshjes së financimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë, Republikës së Italisë dhe Komisionit Evropian, i cili përfaqëson Bashkimin Evropian, për programin e bashkëpunimit (Interreg VI-A) IPA Itali–Shqipëri–Mali i Zi (Adriatiku Jugor) 2021-2027”, Ligjit Nr.139, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, Ligjit Nr. 68/2017, “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, Ligjit Nr.9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, Udhëzimit nr.10, datë 12.07.2024 “Për kontrollin, regjistrimin, përdorimin, rakordimin, raportimin dhe publikimin e fondeve të financimeve të huaja në kuadrin e marrëveshjeve ndërkombëtare”, Marrëveshjes së Partneritetit të nënshkruar ndërmjet Partnerit udhëheqës së Projektit Luka Bar AD dhe institucionit të Bashkisë Durrës, nënshkruar më datë 01.09.2025, për projektin “Sustainable Mobility Upgrade 2.0 - SUMO 2.0”, programi i BE-së Interreg IPA SOUTH ADRIATIC (2021-2027).

Propozimi nga kryetari/këshilltarët/tjetër (*Çfarë propozohet në projektvendim*):

Kryetari i bashkisë, sipas relacionit të hartuar nga Drejtoria e Buxhetit, Drejtoria e Turizimit dhe Drejtoria Ekonomike, i propozon Këshillit Bashkiak të shqyrtojë konform akteve ligjore dhe të vendosë:

1. Miratimin e përdorimit të fondit prej 4,010,444 (katër milionë e dhjetë mijë e katërqind e dyzet e katër) lekë (në vlerën 20% të shumës totale të financimit të projektit nga fondet e Programit Interreg), të ardhur si parafinancim nga projekti SUMO 2.0., me kod të

produktit të projektit G107010 të ardhur nga Dega e Thesarit Durrës dhe të konfirmuar nga Ministria e Financave. Ky fond do të përdoret sipas të dhënave në tabelën e mëposhtme:

| Gr. | Kap. | Programi | Llog. Ekon | Kodi i programit | Kodi i institucionit | Emri i institucionit | Emërtimi i projektit | Kodi i projektit | Fondi në lekë |
|-----|------|--------------------------|------------|------------------|----------------------|----------------------|----------------------|------------------|---------------|
| 00 | 2 | Planifikimi Urban Vendor | 231 | 06140 | 2107001 | Bashkia Durrës | Projekti SUMO 2.0 | G107010 | 4,010,444 |

2. Kjo shumë të përdoret për mbulimin e shpenzimeve për zhvillim të aktiviteteve të projektit që lidhen me tre paketa pune kryesore që synojnë përmirësimin e lëvizshmërisë së qëndrueshme dhe lidhjeve port-qytet në Adriatikun Jugor, si: ekspertiza të jashtme dhe shërbime për takime lokale, udhëtime jashtë vendit, kancelari dhe përkthim/noterizim, përgjatë gjithë kohëzgjatjes së projektit (01.07.2025 – 31.12.2027).
3. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Turizmit, Drejtoria e Buxhetit dhe Drejtoria Ekonomike.

Analiza Financiare/ Buxheti total/natyra e financimit (të ardhurat e veta, transferta etj):

Fondet e Programit Interreg), të ardhur si parafinancim nga projekti SUMO 2.0., me kod të produktit të projektit G107010 të ardhur nga Dega e Thesarit Durrës dhe të konfirmuar nga Ministria e Financave.

Drejtorja/Spektori përgjegjës që ka përgatitur materialin:

Drejtorja e Buxhetit, Drejtoria e Turizmit dhe Drejtoria Ekonomike .

Impakti social/grupet që preken:

Banorët e Bashkisë Durrës.

A është objekt konsultimi: (PO/JO)

JO

Komisioni i përhershëm/përkohshëm i Mardhënive me Jashtë dhe Integritimit Evropian, u mbledhë më datë 11.06.2026, dhe shqyrtoi pikën nr. 2 të rendit të ditës, relacionin dhe dokumentat shoqërues të tij.

Komunikimi midis administratës dhe komisionit i përhershëm/përkohshëm:

Kyestani i komisionit popi: Bërdje nga Administrata e Bashkisë së Durrës, ka tërhequr dhe Njesinë e Integritimit Evropian. e cila në këtë rast është në lidhje me përzgjedhjen në fjalë të...

Mbase dëgjimit të zinj Fllorëta dhe në shprehjen
te gjithë procesit dhe si da shohet në këtë
në tërësi dhe të tjerë.
Në tërësi dhe të tjerë.

Për sa më sipër, pas shqyrtimit, të projekt vendimit dhe materialeve shoqëruese, Komisioni me shumicë votash, vendosi:

T'i propozojnë Këshillit Bashkiak:

- a- Kalimin e projektaktit në mbledhjen e Këshillit për vlerësimin e mëtejshëm dhe për shqyrtim
- b- Miratimin e projekt aktit
- c- Refuzimin e miratimit të projektaktit
- d- Miratimin e projektaktit me ndryshimet si vijon:
- e- _____

Komisioni i Mardhënieve me Jashtë dhe Integritimit Evropian

Kryetar

Luan Nezha

Zv/Kryetar

Ana Dhamo

Sekretar

Arlind Boshku

Anëtar

Dritan Rakipi

Anëtar

Llesh Çuni

Anëtar

Elisabeta Mataj

Anëtar

Arjeta Keçi

FLORETA KËRUSHI
Përfunduese e Bashkisë
Përfunduese e Kështjës së Integritimit Evropian